

VENDIM
Nr. 54, datë 20.12.2024

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME VORË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 20.12.2024, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Vorë sh.a.”,

KONSTATON SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Vorë (UK Vorë) me shkresën nr. prot. 425, datë 11.11.2024, me lëndë “Kërkesë për pajisje me licencë”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Vorë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe “Rregulloren e licencimit”, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Vorë sh.a. (NUIS L62017028A) është themeluar më datë 5.8.2016, me aksionarë Bashkinë Vorë me 100%.

b) Drejtuesja teknike e shoqërisë UK Vorë, znj. Majlinda Bylykbashi, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Ndërtim, në vitin 1991, plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

c) Shoqëria UK Vorë sh.a. deklaron se ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 40,897 banorë të Bashkisë Vorë.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Vorë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht, në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Vorë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Vorë sh.a. me (NUIS L62017028A), në kategoritë:
 - a) Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
 - b) Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.
2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Vorë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
 - a) Drejtues ligjor: Ivi Koja;
 - b) Drejtues teknik: Majlinda Bylykbashi.
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Vorë sh.a. është Bashkia Vorë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Vorë sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Vorë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE
Evis Shurdha